

# KONTRATË

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 613-24-9154-5-2-1/C1000

Komuna e Lipjanit të cilën e përfaqëson, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani në njëren anë (në tekstin e mëtejëmë) Autoriteti Kontraktues;

**DIAMANTI SH.P.K., Rr.Naim Frasheri nr.16, Prishtinë**, (ne vazhdim “Kontraktuesi”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Aneks të rrjetit të ujësjellësit në lagjet në Sllovi dhe Lipjan- Ritenderim me numër identifikues: 613-24-9154-5-2-1

## Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: Aneks të rrjetit të ujësjellësit në lagjet në Sllovi dhe Lipjan- Ritenderim

## Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **57,333.25 €; [pesdhjet e shtatëmijë e treqind e tridhjet e trij euro e njëzet e pesë cent/ Euro.**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

## Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përböhët nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikit Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një originale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	<i>GERTON BYTYQI</i>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	<i>MENAXHER</i>
Nënshkrimi:	<i>Fotoanfis</i>	Nënshkrimi:	<i>H. Bytyqi</i>
Data:	24. 10. 2024	Data:	24. 10. 2024
Vula:		Vula:	



# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 613-24-9154-5-2-1/C1000

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përshtatje apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

**Neni 4****Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te njofoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njostimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizati me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

**OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES****Neni 5****Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë ne dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe përkompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

**Neni 6****Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrate të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

**Neni 7****Ndihma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kérkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme pér të lehtesar prokurimin nga Kontraktuesi pér të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, pér personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit pér familjet e tyre.

## OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

### Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon pértej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit pér shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues pér këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet pér shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme pér qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standarde, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe pér më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj pér cilësinë e punës dhe pér cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur pér realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës pér arsyet e mëposhtme:

- në qoftë se pér kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës pér sigurinë e të gjitha aktivitatave në vend punim.

### Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, pér të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

### Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pér ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KV. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pér çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit te Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Konratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyet e mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe të zgresë çmimin e shpërbimit nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 12 Programi**

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do te përbaje se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor qe kërkohet për dorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e përgjithshme qe do ti zbatoje, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitura e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rriss dytirimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## **Neni 13 Siguria në vend-punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë te cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrate ose që me arsyet mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

## **Neni 14 Ndërhyrja me trafikun**

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tillë si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoshtojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

#### **Neni 15                    Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **Neni 16                    Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

#### **FILLIMI DHE VONESAT**

#### **Neni 17                    Fillimi i punëve**

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

#### **Neni 18                    Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kupuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshire të ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### **Neni 19                    Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoshtojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

## MATERIALET DHE MJSHTËRITË

### Neni 20      Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvèç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave qe duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon qe të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

### Neni 21      Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekt i një kërkese të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkësë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë ripuar.

### Neni 22      Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe përraportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues qe të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitet që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë për vonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, qe të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e këruar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të jepë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritisë se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrëthana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlgimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

#### Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

#### PAGESAT

#### Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjet kërkесës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

#### Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

#### Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVKE nga data e caktuar në KVKE kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garacioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### **Neni 27 Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar “me kërkeshë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

#### **Neni 28 Vërtetimet e pagesës**

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

#### **Neni 29 Llogaritja përfundimtare**

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkrujnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

### Neni 30 Shkaqe përkompensim

30.1 Shkaqe përkompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari përkëtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura përkryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerrë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë përk Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsyet e justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit përmbrashje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa përkryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

#### Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### Neni 32 Testet përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvetësuar tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më përdorim përkufizimi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkoen në kontratë.

## Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjeter për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- të ndërpresë konratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurrit të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

## Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë këruar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

### Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë konratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me konratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/ose
- ndërpërjet e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### Neni 37            Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyen të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijojen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimesinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet t'i paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### Neni 38            Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërsimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projekt do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirim i Ekzekutimit**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkuesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkuesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-9154-5-2-1/C1000

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzime për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kurseve të përmendura për nenit përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>gjuha shqipe</i> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vleres se kontratës për periudhën prej 120 dite.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianeve dhe Materialeve [ <i>shëno shumat</i> ]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [ <i>shëno shumat</i> ]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianeve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [ <i>shëno shumat</i> ]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [ <i>shëno shumat</i> ] (ii) të personave të tjera: [ <i>shëno shumat</i> ]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nenshkrimit te kontrates
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë max 90 dite kalendarike pas nenshkrimit te kontrates, respektivisht deri më 25.01.2025. Cdo tejkalim apo vonesë pas kësaj date do të zbatohen penalet sipas pikës 19.1 të KVK-së.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.

Regjistri i punës	20.1	Me fillimin e punëve do të hapet ditari i punës dhe do të mbahet deri sa të përfundojnë të gjitha punët sipas kontratës.
Pagesa	20.1	Pagesa do të kryhet sipas raportit për punët e kryera për çka menaxheri kontratës harton raport me shkrim
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet Milaim Qeriqi ndërsa MDMK caktohet Kushtrim Jashanica
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>mik ka parapagim</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% te vlerës se kontrates per 1 vit apo 12 muaj i cili do te perdoret per permirsim te defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM</b> të puneve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR</b> , sipas manualit-doracakut të KRPP-së, i publikuar më dt 08.07.2024,
Shkaqet përkompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës ne forme te sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar pas <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM</b> .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë <b>në pajtim me ligjin në Kosovë</b> , ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.  Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## Paramasa dhe Parallogaria

### NDËRTIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT NË DISA ZONA NË QYTETIN E LIPJANIT

a. RRJETI PRIMAR DHE SEKONDAR diameter ( OD 50- 160 mm ) L= 1175 m

b. Kyqjet Shtepiake diameter ( OD 16- 40 mm ) L= 250m

Nr.	Pëshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Totali (€)
<b>Vërejtje:</b> Para porosisë së materialeve, per secilin material të pershkruar në paramasë, menaxherit të kontratës duhet ti ofrohen për aprovim dokumentacionet e nevojshme (si psh. Çertifikatat e kualitetit, katalogjet etj.)					
<i>Punëkryesi duhet të furnizoj dhe montoj nje gardh të përkohshëm me material të fortë përreth vendpunishtes për të siguruar një zhvillim të punimeve pa rreziqe për jetën e pjesmarrësve në punime dhe palës së tretë. Punëkryesi në këtë ofertë duhet të përfshijë edhe koston e ndërtimit të rrugëve të përkoshme për qasje në punishte pa shkaktu dëmtime në teren dhe të kthej terenin në gjendjen e planifikuar. Punëkryesi gjithashtu duhet bëjë furnizime me ujë, energji elektrike etj pranë autoriteteve lokale përkatëse gjatë fazës së ndërtimit. Vërejtje : Punëkryesi duhet qe te posedoje te gjitha instrumentet e nevojshme per detektimin e instalimeve te ndryshme nentoksore dhe te shmang demtimin e këtyre instalimeve nentoksore ne pozicionet ku mund te hasen keto instalime paraprakisht. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjën, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Pozicionet ne projekt Jane te paralogaritura keshtu qe llogaritia e pozacioneve të bëhet sipas gjendjes së realizuar në teren. Nëse kemi punime në rrugë kërkohet edhe plani i menaxhimit të komunikacionit, si pozicion i veçantë.</i>					
<b>1</b>	<b>Punët përgatitore</b>				
1.1	Para fillimit të punimeve duhet të behet piketimi gjëodezik në terren i trasesë së projektuar të rrjetit te ujesjellesit duke perfshirë edhe matjet e gjëodezike për kyçje shtepiake dhe ku duhet të bërë matjet në: aksin e gypit, nyjet, pusetat, valvulat, hidrantët si dhe të gjitha elemente e të tjera të projektit me piketa (shenja me ngjyrë permanente). Këto aktivitete duhet të realizohen në form të vazhdueshme paralel me punimet.	m'	1,425.00	1.00	1,425.00
1.2	Sigurimi i punimeve dhe plani për mbrojtjen në pune: duke përfshirë vendosjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikat në rruget ku planifikohet të zhvillohen punimet e ujesjellsit, paisja e pntoreve me pasisje mbrojtese, vendosja e urave nga druri në pjesët të caktuar te kanalit me fortesi e cila duhet t'i perballoj ngarkesave dinamike për këmbësor dhe të jenë të siguruar edhe në pjesë anësore sipas detalit të paraqitur në Projekt.	Komplet	1.00	1,500.00	1,500.00
1.3	Furnizimi dhe montimin e tabelës informuese (llamarinës dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë) me emrin e projektit, investorit, punëkryesit, vlera e investimeve, data e fillimit të punimeve si dhe data e mbarimit të punimeve.	Komplet	1.00	800.00	800.00
				<b>Gjithsejt me TVSH:</b>	<b>3,725.00</b>
<b>2</b>	<b>Punimet tokësore</b>				

	Gërmimi i dheut të kateg III-IV me makinë dhe dorë, me gjërësi mesatare dhe thellësi mesatare nga kuota e niveletës, varësisht nga diametrat e gypave: Për gypat: OD 160, b=0.50m dhe h=1.0m; OD 110, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 90, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 75, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 63, b=0.40m dhe h=1.0m; OD 50, b=0.40m dhe h=1.0m;				
2.1	-Me makinë 90 %	m <sup>3</sup>	641.25	5.50	3,526.88
2.1.2	-Me dorë 10 %	m <sup>3</sup>	71.25	5.50	391.88
	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktesi ±1cm.	m <sup>2</sup>	71.25	0.10	7.13
2.2	Furnizimi dhe vendosja e rërës me fraksion 0-16mm nën,mbi dhe anash gypit me planifikim dhe ngjeshje çdo 20-30 cm vetem ne vende ku eshte e nevoshme.	m <sup>3</sup>	249.38	10.00	2,493.75
2.3	Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar në shtresa çdo 20-30 cm me ngjeshje 40 Mpa	m <sup>3</sup>	213.13	1.00	213.13
2.4	Furnizimi dhe instalimi i shiritit detektues me fije teli mbi gypin e instaluar: Shiriti duhet të lidhet me pjesët e shkeputara (vazhduese-me lidhese-kllapë) dhe me pjesët fazonike si dhe gjithashu duhet të bëhet edhe testimi i detektimit para mbulimit të kanali dhe në prani të organit mbikqyres.	m'	1,425.00	1.00	1,425.00
2.5	Matja gjeodezike e elementeve të rrjetit si dhe matja e gypit para mbulimit të kanalit në çdo thyerje horizontale, vertikale dhe ne pikat e saldimit (për gypa >40mm), të dhenat e matjeve duhet te pergaditen ne formatin DWG dhe EXCEL dhe te dorezohen në raporte javore tek KRUP-DPZH.	m'	1,425.00	0.40	570.00
2.6	Mbulimi i kanalit me zhavor (31.5mm) të përpunuar deri në nivelin e asfaltit,betonit dhe kubëzave në shtresë çdo 20-30 cm me ngjeshje 80 Mpa, vetem ne vendet ku eshte e nevojshme.	m <sup>3</sup>	250.00	10.00	2,500.00
2.7	Largimi i dheut të tepërt në deponinë legale per hudhjen e materialeve Inerte.	m <sup>3</sup>	499.38	4.00	1,997.50
2.8	Prerja e asfaltit me gjërësi varesisht sipas nevojes, dhe largimi i tij në deponinë legale. Çmimi të ofrohet për prerjen e asfaltit në të dy anët, si dhe prerja e pjeseve te demtuara gjatë punimeve. Kalkulimi behet per meter katrore.	m <sup>2</sup>	130.00	4.00	520.00
2.9	Kthimi i asfaltit në gjendjen fillestare në dy shtresa: Furnizimi, shtrirja dhe punimi i shtresës së bitoagregatit 0-32CS mm me trashësi t=7 cm dhe Furnizimi, shtrirja dhe punimi i asfaltit binder 0-16S mm me trashësi t=4cm,. Ne cmim te përfshirë edhe spërkatjen me emulsion 0.4kg/m <sup>2</sup> të sipërfaqes së binderit.	m <sup>2</sup>	140.00	25.00	3,500.00

2.10	Zhvendosja e kubzave të betonit dhe anësoreve para gërmimit te kanalit në gjëresi sipas nevojës si dhe kthimi i tyre në gjendjen ekzistuese. Në cmim te perfshihen të gjitha punet e nevojshme: si psh. zallë i imtë, betoni i varfër per nivelim te anesoreve, si dhe rruajta apo zevendesimi me te reja i kubezave dhe anësoreve te demtuara gjatë punës.	m2	50.00	8.00	400.00
2.11	Slgurimi dhe vendosja e kubzave të betonit dhe anësoreve të cilat dëmtohen gjatë ndetimit të rrjetit 30%	m2	30.00	15.00	450.00
2.12	Prerja e betonit në pjesët ku do të kalojnë gypat primar dhe kyçjet shtepiake, kalimet apo depertimet e mureve, rrethojave, gardhet gjatë gërmimit të kanalit dhe largimi i tij në deponinë legale. Ne çmim te perfshihet edhe kthimi ne gjendjen e mëparshme.	m2	30.00	15.00	450.00
2.13	Identifikimi dhe punimi i punëve të paparashikuara duke përfshirë :Dëmtimet e kabllove të telefonisë,tensionit të lartë dhe tjera,gypave të ujësjellësit,furnizimin e përkohëshëm me ujë përmes gypave (Bay Pas) deri sa të bëhën kyqjet përfundimtare, kanalizimit dhe dëmtimet tjera si dhe dislokimet e gypave të larcekura, pompimin e ujit etj.	komplet	1.00	2,000.00	2,000.00
2.14	Punime të nevojshme per thyerje të betonit (si psh. të pustave të kanalizimit, të ujësjellësit, dhe dislokimin e tyre), Kalimet apo depertimet e mureve, rrethojave, gardheve, gate punimeve në trasen e gypave rrugor dhe gypave të kyçeve shtepiake. Ne cmim te merret parasysh edhe kthimi ne gjendjen e mëparshme.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
2.15	Germimi i dheut për zbulimin gypave eksistues per kyçje dhe pusetave.	m³	7.50	8.00	60.00
2.16	Depertimi i rruges me shpimi horizontal të tokës për vendosjen e gypit të ujësjellësit PE100 RC OD110mm. Në çmim të përfshihet edhe vendosja e gypit mbrojtës me diametër të brendshëm për 10 centimetra më të madh se sa gypi i ujësjellësit	m'	50.00	50.00	2,500.00
				<b>Gjithsejt me TVSH:</b>	<b>24,005.25</b>
<b>3</b>	<b>Punët e Betonit</b>				
3.1	Ndërtimi i pusetave sipas detaleve. Dimensionet dhe gjeometria e pusetave te përshatatet me montimin e pjesëve fazonike. Në çmim të llogaritet te gjitha punet e nevojshme si (Germimi i vendit te pusetes, punet latuse,dhe te gjitha punet e nevojshme sipas kushteve teknike) dhe detalit të dhenë, Betoni i armuar duhet te jete i papershkrueshem nga uji, sipas SN EN 206_1:C30/37; XC4; Dmax32; Cl 0.10; C3. Kalkulimi behet per vellim te betonit. Në çmim duhet te llogaritet edhe armatura S500B për pusetat e betonit.	copë	10.00	450.00	4,500.00
3.2	Furnizimi dhe punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyje antikorrozive.	copë	10.00	10.00	100.00

3.3	Sigurimi dhe vendosja e betonit me klase C25/30 me qëllim të inkastrimit të gypësjellësit në kthesa horizontale dhe vertikale, në çmim të parashihet edhe betoni dhe ankerimi ne puseta për fazonerit e mountura në pusetat e kyçjes, kalimit të rruges dhe valvolës së ajrit.	m <sup>3</sup>	10.00	50.00	500.00
3.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut nga metali apo kompoziti me aftësi mbajtëse 40 ton	copë	10.00	160.00	1,600.00
			<b>Gjithsejt me TVSH:</b>		<b>6,700.00</b>
<b>4</b>	<b>Punët montuese</b>				
4.1	<b>Furnizimi, lindhja (montimi - saldimi ballor) dhe vendosja e gypave të PE-100-RC; SDR 17; PAS 1075 Tipi-2 dhe në përputhje me normat dhe standartet e përcaktuara ne specifikacionin inxhinierik.</b>				
4.1.1	OD-160 mm, PN - 10.0 bar	m'	175.00	16.00	2,800.00
4.1.2	OD-110 mm, PN - 10.0 bar	m'	1,000.00	7.10	7,100.00
4.2	<b>Furnizimi dhe montimi i pjesëve fazonike nga giza GGG 40 ose GGG 50 (komplet me bulona, dado dhe gomina- diktuna). Vërejtje: Te gjitha matrilalet duhet te jene në perputhje me specifikacionin inxhinierik të bashkangjitur me projekt.dhe në përputhme me normat dhe standartet e përcaktuara poashtu në specifikacionin inxhinierik.</b>				
4.2	<b>Nyja N1-Kyçja në rrjetin ekzistues</b>				
4.2.1	Multi joint DN 160, PN 16	copë	1.0	120.00	120.00
<b>4.2.2</b>	<b>Puseta 1-Ujematesi zonal</b>				
4.2.2.1	Valvulë shiber DN - 150 mm , PN 16	copë	2.0	315.00	630.00
4.2.2.2	Fazon FF -DN-150/500 mm , PN 16	copë	3.0	165.00	495.00
4.2.2.3	Fazon FF -DN-150/300 mm , PN 16	copë	1.0	140.00	140.00
4.2.2.4	Adapter Flansh për PE OD - 160mm PN 16	copë	2.0	60.00	120.00
4.2.2.5	Filtrues -DN - 150mm N 16	copë	1.0	400.00	400.00
4.2.2.6	Montues Demontues DN - 150mm PN 16	copë	1.0	290.00	290.00
4.2.2.7	Ujëmates Zonal Woltman DN 100mm PN 16	copë	1.0	490.00	490.00
<b>4.2.3</b>	<b>Nyja (N-3) Puseta Shkarkuese</b>				
4.2.3.1	T DN 100/50, PN 16	copë	1.0	190.00	190.00
4.2.3.2	Adapter Flansh për PE OD - 110mm PN 16	copë	2.0	30.00	60.00
4.2.3.3	Adapter Flansh për PE OD - 63mm PN 16	copë	1.0	20.00	20.00
4.2.3.4	Valvulë me teleskop DN - 50 mm PN 16	copë	1.0	160.00	160.00
4.2.3.5	Kthesë 90 DN - 50 mm PN 16	copë	1.0	50.00	50.00
4.2.3.6	Fazon FF DN-100/600 mm PN 16	copë	2.0	130.00	260.00
4.2.3.7	Fazon FF DN-50/600 mm PN 16	copë	1.0	71.00	71.00
<b>4.2.4</b>	<b>Puseta e ajrit</b>				
4.2.4.1	T DN 125/90 PN 16	copë	1.0	190.00	190.00
4.2.4.2	Adapter Flansh për PE OD - 110mm PN 16	copë	2.0	30.00	60.00
4.2.4.3	Valvulë me teleskop DN - 110 mm PN 16	copë	1.0	260.00	260.00
4.2.4.4	Fazon FF DN-110/600 mm	copë	2.0	116.00	232.00
4.2.4.5	Valvulë e ajrit DN 125mm	copë	1.0	450.00	450.00

		Gjithsejt me TVSH:			14,588.00
<b>5</b>	<b>Realizimi i kyçjeve për konsumatorë</b>				
<b>5.1</b>	<b>Punët tokësore</b>				
5.1.1	Gërmimi i kanalit me makineri dhe me dorë (me dim. 0.3m x 0.8m),	m3	60.0	8.00	480.00
5.1.2	Furnizimi dhe vendosja e rërës me fraksion 0-16mm nën,mbi dhe anash gypit me planifikim dhe ngjeshje çdo 20-30 cm	m3	22.5	10.00	225.00
5.1.3	Mbulimi i kanalit me zhavor (31.5mm) të përpunuar deri në nivelin e asfaltit,betonit dhe kubëzave në shtresë çdo 20-30 cm me ngjeshje 80 Mpa	m3	37.5	10.00	375.00
<b>5.2</b>	<b>Punët Instaluese-montuese</b>				
5.2.1	Furnizimi, vendosja dhe lidhja e gypave <b>PE-100-RC tip2, PN10bar</b> me diametra prej Ø20 deri në Ø40 mm, per realizimin e kyçjeve shtëpiake ( mesatarisht 5-25 metra gjatësi për kycje).	m'	250.0	1.00	250.00
5.2.2	Furnizimi, dhe instalimi i pjesëve fazonike të nevojshme për lidhjen e gypave shtëpiak ekzistues me gypat rrugor. Në çmim të përfshihen: -Qaforet nga materiali PE me saldim elektrofuziv, per kycje ne gypat me diametra prej Ø50 deri në Ø160. -Kthesat lidhëse nga materiali PE -Gjysmë Lidhëset nga materiali PE - Si dhe te gjitha pjesët e nevojshme për funksionimin e plotë.				
	Kyçjet në gypin Ø 160 mm	copë	3.0	50.00	150.00
	Kyçjet në gypin Ø 110 mm	copë	14.0	40.00	560.00
	Kyçjet në gypin Ø 90 mm	copë	2.0	30.00	60.00
	Kyçjet në gypin Ø 75 mm	copë	2.0	30.00	60.00
	Kyçjet në gypin Ø 63 mm	copë	2.0	30.00	60.00
	Kyçjet në gypin Ø 50 mm	copë	2.0	30.00	60.00

	Pusete ujematesi, duke perfshire te gjitha elementet e para fabrikuara, per instalim nentokesor, me mates koncenterik. <b>Ne kete pozicion perfshihen: Njesia e kompletuar me tubin mbrojtës, kolektori lidhes, dhe kapaku i mbylljes (kapaku siperfaqesor).</b> Pusete e pa pershkueshme uji Klasa 1 (WIS4-37-01), Puseta me lartesi variabile, Kapaku me mundesi fleksibile montimi ne varesi te pozicionit dhe kendit te terenit ku montohet. Me valvole mbyllese mbyllje ne 90°, Kapaku i mbylljes siper klasa B 125 me aftesi mbajtese sipas EN 124 (Shkalla B sipas British Standard), Me mbrojtje nga ngricat deri ne -15°C ne perputhje me WIS 4-37-01, Me mbushje shkume poliruetan apo e ngjashme per pjesen e izolimit termik, Ne pozicion po ashtu duhet te perfshihet valvola jo kthyese, Ne cmim gjithashtu duhet te perfshihen edhe lidheset kompresive per PE Ø 32 mm ne hyrje dhe Ø 32 mm dhe Ø 25 mm ne dalje. <b>Ne kete pozicion perfshihet ujematesi koncentrik me 1 1/2" me filetim. Q3 = 2.5 m³/h, i aprovuar sipas MID R 160, PN 16.</b> <b>Kapaku perfundimtar i mbylljes duhet te vendoset me beton te thjesht korniza e betonit 15 x 10 cm, betoni i klases C 12/15</b>				
5.2.3		copë	25.0	230.00	5,750.00
6	<b>Testimi dhe dezinfektimi i gypave</b>			<b>Gjithsejt me TVSH:</b>	<b>8,030.00</b>
	<b>Testimi</b>				
6.1	Me përfundimin e montimit, para mbulimit të kanalit të bëhet testimi hidraulik i gypësjellësit në presion provues sipas udhëzimeve të prodhuesve të gypave dhe pjesëve fazonike dhe në pajtim me kushtet teknike dhe në prezencën e organit mbikqyrës. Llogaria në m' të gypësjellësit të testuar.	m'	1,425.00	0.05	71.25
	<b>Dezinfektimi</b>				
6.2	Para lëshimit në punë të gypësjellësit është e nevojshme të bëhet dezinfektimi sipas rregullave të njohura të dhëna në kushtet teknike të egzekutimit dhe në prezencë të organit mbikqyrës. Llogaria në m' të gypësjellësit të dezinfektuar.	m'	1,425.00	0.05	71.25
7	<b>Punët Përfundimtare</b>			<b>Gjithsejt me TVSH:</b>	<b>142.50</b>

7.1	Pas perfundimit (implementimit) dhe para pranimit teknik final të projektit, duhet të bëhet kompletimi i dokumentacionit teknik ku duhet te perfshihet i gjithe dokumentacioni duke perfshirë: Situacionin e rrjetit, Profilet gjatesore te zbatuara, detalet e pusetave, nyjet, fotot gjate imppementimit dhe inqizimi gjeodezik i trases sipas pershkrimit ne specifikacionin teknik (Inxhierik) dhe të dorëzohen në formë manuale (kopje e fortë) dhe digitale (DWG dhe SHAPFILE) në 3 kopje. Kopjet e forta duhet të janë të përgaditur me përpjesë sipas normave teknike të projektimit.	m'	1,425.00	0.10	142.50
			<b>Gjithsejt me TVSH:</b>		<b>142.50</b>
<b>Rekapitulimi</b>					
Nr	Pëshkrimi i punëve	Çmimi me TVSH			
1	<b>Punët përgatitore</b>	<b>3,725.00 €</b>			
2	<b>Punimet tokësore</b>	<b>24,005.25 €</b>			
3	<b>Punët e Betonit</b>	<b>6,700.00 €</b>			
4	<b>Punët montuese</b>	<b>14,588.00 €</b>			
5	<b>Kyçjet e lidhjeve individuale</b>	<b>8,030.00 €</b>			
6	<b>Testimi dhe dezinfektimi i gypit</b>	<b>142.50 €</b>			
7	<b>Punët Përfundimtare</b>	<b>142.50 €</b>			
	<b>Totali i përgjithëshëm me TVSH:</b>	<b>57,333.25 €</b>			